

UDHËZIM
Nr.3, datë 6.5.2006

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në kapitullin III, shkronja b”, “Pjesa e veçantë”, të udhëzimit nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Në fund të paragrafit të pestë të pikës 1 “Për prokurimin e ndërtimeve” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ndërsa për objektet me vlerë nga 200 000 000 (dyqind milionë) deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, vlera e objekteve të realizuara në pesë vitet e fundit të jetë jo më pak se 50 për qind e vlerës së objektit që prokurohet dhe vlera e njërit prej këtyre objekteve të jetë jo më pak se 20 për qind e kësaj vlere.”.

2. Paragrafi i shtatë i pikës 3.1 “Për shërbimet e projektimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kriteret vlerësuese për projektimet do të jenë: 50 pikë për ofertën teknike, që nënkupton cilësinë e projektit; 25 pikë për përvojën e stafit inxhinierik në projekte të ngjashme; 5 pikë për ofertën ekonomike, që nënkupton vlerën e preventivit paraprak të projektit; 20 pikë për çmimin e vetë projektit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha